

2 persona arrestohen në Gjakovë pasi u gjenden armë



26/09/2023 18:06

f

t

Policia e Kosovës në Gjakovë ka arrestuar dy persona të dyshuar për posedim të paautorizuar të armëve.

Bëhet fjalë për dy raste të ndara për të cilat Policia e Kosovës kishte siguruar video-incizime ku në posedim të të dyshuarve janë parë armë.

“Në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, si rezultat i informatave të pranura janë zhvilluar hetime dhe është arritur të identifikohen dhe arrestohen dy të dyshuar. Në njërin rast i dyshuari me inicialet A.Rr., shtetas i Republikës së Kosovës ka dorëzuar një pushkë automatike me një karikator dhe nëntë (9) copë fishekë, ndërsa në rastin tjetër i dyshuari me inicialet M.A., shtetas i Republikës së Kosovës, ka dorëzuar një pushkë automatike me një karikator dhe një (1) fishekë. Armët dhe municionin të dyshuarit i kishin në posedim të paautorizuar dhe të njëjtat janë konfiskuar”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Sipas njoftimit të Policisë, personat e arrestuar janë liruar në procedurë të rregullt ndërsa ndaj tyre është iniciuar rast “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Artikuj të ngjashëm



September 26, 2023

Flasin pelegrinët që ishin në Manastirin e Banjskës: KFOR-I hyri brenda,...



September 26, 2023

Diaspora dorëilirë: Kaq para dërgoi diaspora gjatë vitit 2023



September 26, 2023

Kurti: Dy vjet më parë Serbia dërgoi avionë luftarakë në kufi,...



September 26, 2023

Serbia duhet të bëjë thirrje për heqje dorë nga dhuna, thotë...



September 26, 2023

Sulmi terrorist në veri, Kurtit i shkon në zyrë ambasadori britanik



September 26, 2023

I mbijetuari i masakrës së Isbicës shpërthen në lot tek familja...

LAJME TË FUNDIT

Flasin pelegrinët që ishin në Manastirin e Banjskës:...

Kurti: Dy vjet më parë Serbia dërgoi avionë...

Sulmi terrorist në veri, Kurtit i shkon në zyrë ambasadori britanik

Diaspora dorëilirë: Kaq para dërgoi diaspora gjatë vitit 2023